

## **NËTËNDITËSHI I SHPIRTIT SHENJT**

Biblioteka: “**Burimi i Jetës**”

Originali është në gjermanisht dhe i botuar në Austri.

Përktheu: m. Sjvetlana Rezo BDH dhe Drita Gjini

Korigjuar: Profesor. Izota Avdili

Lektorë: Valbona dhe Visar Berisha

Sponzori: Ivka Martinović

I nderuar lexues,

Këtë nëntëditësh e kam përjetuar vet gjatë një takimi në një famulli afër Zagrebit, ku famullitari takohej me të rinjtë, në përgatitje të Rrëshajëve. Më pas në Shqipëri me një grup bashkëpunëtorësh të mi e kam përkthyer këtë libërth, kopjuar dhe pastaj e kemi shpërndarë në mes motrave të nderit, meshtarëve dhe familjeve të cilat dëshironin ta përdornin në lutjet e tyre. Ky nëntëditësh mund të përdoret për ripërtëritje shpirtërore edhe gjatë festave të famullive. Falënderoj përzemërsisht bashkëpunëtorët e mi në Shqipëri që ndihmuan në përkthimin e këtij libërthi. Në mënyrë të veçantë falënderoj Valbonën dhe Visarin që lekturuan këtë tekst dhe e bënë të shijshëm atë për lexuesin. Në fund falënderoj kushërirën time Ivka Martinovic e cila ka financuar këtë libërth.

Libërthi do të shpërndahet përmes bibliotekës Burimi i Jetës, frimzuar në Ezekieli 47.

Lus Hyu që të bekoj me huret tija të gjithë ata që ndihmuan në daljen e këtij libërthi si dhe ata tek të cilët ky nëntëditësh do të arrij.

m. Svjetlana Rezo BDH

## NËNËTDITËSHI I SHPIRTIT SHENJT

### ..... **Dita e parë      La v d e r i m i d h e a d h u r i m i** .....

Hyrja:

Meshtari: Eja o Shpirti Shenjt, Ti Shpirt i URTISË.

Të gjithë: Flaka jote zbulon tërë urtinë e kësaj botë, / furtuna jote shkatërron gjithçka që është e fortë / dhe përtërinë gjithçka që është e dobët.

M. : Eja o Shpirti Shenjt, Ti Shpirt i KUPTIMIT.

Të gjithë : Vetëm nëpër Ty e kuptojmë rrugën / për të cilën na ke thirrur.

M. : Eja o Shpirti Shenjt, Ti Shpirt i KËSHILLËS.

Të gjithë :Ti largon dyshimin dhe pasigurinë, / që ne të mund ta njohim vullnetin e Hyjut.

M. : Eja o Shpirti Shenjt, Ti SHPIRTI i FORCËS.

Të gjithë : Nëpër forcën tënde apostujt, martirët dhe dëshmitarët janë forcuar që ta dëshmojnë Krishtin.

M : Eja o Shpirt Shenjt, Ti SHPIRTI i DIJES.

Të gjithë : Që në krijim e njohëm fuqinë tënde / në Shkrimin Shenjt, urtinë tënde / në shëlbim, dashurinë Tënde.

M. : Eja o Shpirti Shenjt, Ti Shpirti i PËRSHPIRTËRISË .

Të gjithë : Në Ty kemi pranuar Shpirtin e fëmijërisë e plotë / hare të falënderojmë dhe të thërrasim: Aba, At i dashur!

M. : Eja o Shpirti Shenjt, Ti Shpirti FRIKËS SË TENZOT.

Të gjithë : Vetëm Ti na bënë të jemi të përsosur / të njohim mëkatet njerëzore / dhe shenjtërinë e Hyut.

Meshtari: Të lutemi.

O Hyj i Gjithëpushtetshëm, Ati i Zotit tonë Jezu Krishtit, Kisha jeton në Shpirtin Shenjt të cilin Ti e ke dërguar, të lutem na mbush sa më shumë me Fuqinë e Tij. Na jep Shpirtin e URTISË, dhe KUPTIMIT; Shpirtin e KËSHILLËS; Shpirtin e DIJES dhe FORCËS, Shpirtin e PËRSHPIRTRISË dhe Shpirtin e FRIKËS SË TENZOT. Nëpër Krishti Zotin tonë...

Të gjithë: AMEN.

L E X I M I: Izaia 11, 1-6.

**Një pinjoll do të dalë nga trangu i Jeseut, një pip i zgjedhur do të piptohtë nga rrënja e tij. Në të do të pushojë Shpirti i Zotit, Shpirti i urtisë e i dijes, Shpirti i këshillave dhe i forcës, Shpirti i kuptimit dhe i frikës së Zotit. Kënaqësia e tij do të jetë në frikën e Zotit. S' do të gjykojë sipas pamjes së syve as s' do të vendos sipas thashethemeve, por do t' i gjykojë me drejtësi skamnorët, do t' u jap gjyq të drejtë të përvuajturve të vendit, me thuprën e fjalëve të veta do ta godasë vendin e me frymën e gojës së vet do të vrasë të paudhin. Brezi i kryqit të tij do të jetë drejtësia, me besnikëri do t' i ngjesh ijet. Ujku do të hajë me qengjin, përbri kecit do të shtrihet leopardi, viçi e këlyshi i luanit bashkë do të kullotin, fëmija i vogël do t' i çojë e do t' i bjerë.**

- I. : Shpirti i Zoti mbushë tërë rruzullimin, / i bashkon të gjithë dhe të gjitha gjuhët i njeh.
- II: : O Shpirt i Hyut, Kisha e bashkuar në Ty / madhëron lavdinë e Hyut sepse vazhdon Veprat e Birit të Tij në tokë.
- I. : Të falënderoj o Atë për besnikërinë tënde. / Në Shpirtin Shenjt kuptojmë veprën tënde, dhe plotësojmë Fjalën tënde.
- II. : Nëpër Shpirti Shenjt mbetemi në dashurinë tënde. / Ai na ndihmon që të kuptojmë çfarë na flet Biri Yt / dhe të kuptojmë çka na mëson Ai.
- I. : Po të lëvdojmë o Krisht, me ringjalljen Tënde / na zbulon fuqinë tënde, dhe na thua: / po ju jap paqen, po ju lë paqen.
- II. : Me forcën e Shpirtin Tënd të Shenjt dëshmojmë për Mbretërinë Tënde, / për drejtësinë, paqen dhe dashurinë Tënde.
- I. : Po të lëvdojmë o Shpirti Shenjt! Ti forca e fesë sonë, / Ti forca e shpresës dhe dashurisë sonë.
- II. : Përfundoje veprën e krijimit tënd. Na ndihmo / që të piqet ajo farë që në ne e ke mbjellur. O Zot, le të vij Mbretëria Jote.
- I. : Hiri dhe paqja prej Zotit, Atit tonë, dhe Zotit tonë Jezu Krishtit / në bashkim me Shpirtin Shenjt, qoftë me ne.
- II. : Si ka qenë në fillim ashtu tash / e përgjithmonë e jetës. Amen.

#### PREDIKIM – MEDITIM

Të gjithë atë çka gjuha e njeriut përdorë për ta shpjeguar Shpirtin, si: fryma, flaka, stuhia, para së gjithash na tregojnë se Shpirti Shenjt nuk u nënshtrohet planeve njerëzore. Atë nuk mund ta urdhërojmë. Ai fryn kur të dëshiroj. Por kjo nuk ndodhë pa ndonjë shkak dhe pa planifikuar, se Ai është Fjala e cila e shfaq forcën e vet të pa kufi. Në të është shpresa për botën e Re. Planet dhe veprat njerëzore nuk kanë mundësi ta posedojnë këtë krijesë të Re, që ne e presim me mall. Kjo është dhuratë e Shpirtit Shenjt, por Shpirti përsëri është dhuratë të cilën na e ka falur Jezu Krishti Zot, që ajo dhuratë të qëndrojë përgjithmonë me ne.

## LUTJA E SHKURTËR E BESIMTARËVE:

Udh : O Zot, Ti ke bashkuar të gjithë ata, që e mbajnë emrin e Jezusit / nëpërmjet pagëzimit me forcën e Shpirtit Shenjt:

P. : Bën që besimtarët të jenë se bashku një shpirt dhe një zemër.

Udh : Ti dëshiron që Shpirtit Shenjt të veprojë në mbarë botën:

P. : Na ndihmo që të ndërtojmë botën në paqe dhe drejtësi.

Udh : Ti nëpër Shpirtin Shenjt ke ringjallur Jezusin:

P. : Jepu të vdekurve jetën e re.

Meshtari: Të lutemi:

O Zot, i Shenjt dhe amshuar. Ti na ke dërguar Shpirtit Tënd të Shenjt; vetëm Ai mund ta ndryshojë botën, vetëm Ai mund ta krijojë ose shndërrtojë njeriun në shenjtërinë dhe drejtësinë e vërtetë.

P. : Amen.

## LUTJA ZOJËS SË BEKUAR

I. : O Mari, Nëna e Tenzot dhe Nëna jonë, / po të lutemi na jep ndihmën tënde.

II. : Ti je lavdia e Jerusalemit, / të je gëzimi i Izraelit, / ti je këshilla e popullit tonë.

I. : Ti je Nëna e besimtarëve, / lutu për ne që ta kemi fenë e plotë.

II. : Ti je shërbëtorja e Fjalës së Zotit, / lutu për ne që t'i shërbejmë sa më mirë Asaj.

I. : Ti Nënë e vuajtjeve, / lutu për ne që mos të tërhiqemi para vuajtjeve të tjerëve.

II. : Ti froni i shenjtërisë, / lutu për ne që ta kemi urtinë në shpirt dhe në zemër.

I. : Ti shkak i gëzimit tonë, / lutu për ne që të shkëlqejmë me gëzim.

II. : Ti Mbretëreshë e paqes, / lutu për ne që paqja e Krishtit të sundojë në ne.

I. : Ti Nënë e këshillit të mirë, / lutu për ne që ta njohim vullnesën e Hyut.

II. : Ti shpresa jonë, / lutu për ne që ta arrijmë shëlbimin e amshuar.

Meshtari: Po të lutemi.

O Hy – Biri yt i ka quajtur të lumë të gjithë ata që e dëgjojnë Fjalën tënde dhe e zbatojnë atë në jetë. Nëpër ndërmjetësinë e Zojës së Bekuar, na ndihmo që të jetojmë ashtu që edhe ne ta shohim misterin e shëlbimit tonë. Nëpër Krishtin, Zotin tonë.

P. Amen.

.....

**Dita e dytë: Pëndesa dhe këthimi**

.....

Shiko Hyrja

LEXIMI: Mateu 3, 7-11.

“Kur pa se shumë farisenjë e saducenjë po i vinin në pagëzim, u tha: “Pjellë shlligash, kush ju mësoi t’i ikni zemërimit që po vjen? Bëni, pra, vepra të denja kthimit! As mos t’ju bjerë në mend të thoni në vete: ”Kemi Atë Abrahamin!” Sepse unë po ju them: Hyji mund t’i nxjerrë Abrahamit bij edhe prej këtyre gurëve! Tashmë shpata u vu në rrënjë të lëndëve; çdo lëndë që nuk jep fryt të mirë, pritët dhe qitet në zjarr. Unë po ju pagëzoj me ujë në shenjë kthimi, kurse ai që po vjen pas meje, është më i fortë se unë e vetë nuk jam i denjë as t’ia zbath të mbathurat: Ai do t’ju pagëzojë me Shpirtin Shenjt e me zjarr.”

**RRËMIMI I MËKATEVE (sipas fjalës së Jezusit):**

Meshtari : Krishti thotë: “Adhuro Zotin, Hyun tënd, dhe shërbej vetëm Atij! (Mt 4,10).

Pyesim veten : A e kërkoj bashkimin me Zotin? Në lutje? Në sakramente, a po i largohem shikimit të Zotit? Ndoshta kam pak kohë për Të, ose nuk kam fare kohë? A e kundërshtoj me vullnesën time vullnesën e Zotit? A jam i vetëdijshëm që Zoti është me i madh se të gjitha mendimet e mia? A kam ndrojtje dhe nderim para Tij. (ndalesa)

Krishti thotë : ”Eja pas meje!” (Mt 9,9).

Pyesim veten: A përpiqem ta njoh Krishtin sa më mirë, t’i njoh mësimet dhe veprat e tij? Nga i drejtoj veprimet dhe lëshimet e mia? A ia kam falë ndonjëherë me vetëdije jetën time Jezu Krishtit? (ndalesa)

Krishti thotë: ”Gjithçka dëshironi t’ju bëjnë juve njerëzit, bëni edhe ju atyre!” (Mt 7,12).

Pyesim veten: A përpiqem t’i kuptoj afërmit e mi edhe atëherë kur mendojnë dhe jetojnë ndryshe nga unë? A i fshihem ndonjë personi që mos ta takoj në rrugë? A kam kurajo të kërkoj falje dhe t’i pranoj gabimet e mija? (ndalesa)

Krishti thotë: “Ju dhashë shembull që, sikurse ju bëra unë juve, të bëni edhe ju.” (Gjn 13,15).

Pyesim veten: A po përpiqem të bëhem i mirë, të zotëroj dëshirat dhe epshet e mija, në mënyrë që t’i pushtoj dobësitë dhe forcoj aftësitë e mija për të mirë? A jam përtac? A jam i rreptë? A jam përplot me dëshira të kësaj bote? (ndalesa)

Krishti thotë: ”Kush dëgjon ju, dëgjon mua. Kush përbuz ju, përbuz mua. Kush përbuz mua, përbuz Atë që me dërgoj” (Lk 10,16).

Pyesim veten: A po mundohem të jetojë me Kishën ose me bashkësinë time famullitare? A po e ndihmoj Kishën apo vetëm e kritikoj atë? A lutem për ripërtëritjen e Kishës dhe bashkimin e të krishterëve!

## PSALMI LUTET NË DY KORE

- I. : Ki mëshirë për mua, o Hyu, sipas mëshirës sate, / pashë mirësinë tënde shlye mëkatin tim .  
II. : Më laj krejtësisht prej mëkatet tim, / mëkatin tim përherë e kam para sysh.
- I. : Sepse e pranon paudhësinë time, / mëkatin tim përherë e kam para sysh.  
II. : Ty, vetëm Ty të kam rënë në faj, / dhe kam bërë çka është keq para teje. / Prandaj je i drejtë sado të më ndëshkosh, / dhe i pa anshëm në dënimin tënd.
- I. : Ja, mëkatar u linda, / madje në mëkate nëna ime më ngjizi.  
II. : Por, Ti që e do çiltërsinë e zemrës, / m'i mëso thellësitë e dijes së shpirtit.
- I. : Më stërpik me hisop e do të bëhem i pastër, / me laj e do të bëhem më i bardhë se bora.  
II. : Largo shikimin tënd prej mëkateve të mia, / shlyej të gjitha fajet e mia.
- I. : Krijojë në mua, o Hyj, zemrën e pastër, / përtëri në mua një shpirt të qëndrueshëm!  
II. : Mos më flak larg fytyrës sate, / mos hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjt.

## LUTJA E SHKURTËR E BESIMIT

Udhëheqësi: Shumëzoje o Zot, numrin e shërbëtorëve të tu, të cilët sipas urdhërimeve të tua shpallin fjalën e faljes, të lutemi:

Të gjithë: O Zot, dëgjona ne!

Udhëheqësi: Mëkatarëve jepu fuqinë që të kthehen në rrugën e mirë, të lutemi!

Të gjithë: O Zot, dëgjona ne!

Meshtari:

O Zot, i mëshirshëm – nëpër Shpirti tënd të Shenjt na ndihmo që ta sundojmë forcën e së keqes. Na ruaj që të mos largohemi me veprimet tona prej teje. Nëpër Krishtin Zoti tonë.

Të gjithë: Amen.





## **NXITJA PËR ZBATIM PESONAL**

Unë jam i bindur o Zot, që të njoh pak, shpesh ndihem se kam pasur nevojë për ta kuptuar të vërtetën tënde sa më thellë. Por e kuptoj se prej kësaj varen shumë gjëra të tjera, për këtë të lutem me dhuro dhuratën e KUPTIMIT. Nëse Fjalën tënde e kuptoj sa më mirë, ajo do të jetë për mua e çmuar, dhe kur do ta përjetoj fenë në krejt bukurinë e saj, ky përjetim do të më forcojë të punoj sipas vullnesës sate. Dëshiroj të jem i sinqertë e i gëzuar në fenë time, që të tjerët nëpër mua të vijnë tek Ti. Atyre dëshiroj që jeta tu jetë e mbushur me Lajmin e Gëzueshëm ndaj dashurisë tënde. O Zot, po të lutem për dhuratën e KUPTIMIT.

## **LUTJA E SHKURTËR E BESIMTAREVE**

U. : Më forcën e Fjalës tënde drejtoji të fuqishmit e kësaj botë, të lutemi!

P. : O Zot, dëgjona ne!

U. : Bëjë që ata që janë të mbushur me kundërshtime dhe kritika, të jenë të shndritur me dhuratën e KUPTIMIT, të lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

U. : Shembi muret që ndajnë popujt, të lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

Meshtari: të lutemi.

O Zot, Hyu ynë – vetëm në Ty gjejmë jetën dhe kuptimin. Udhëhiqe Kishën tënde që të kuptojë sa më thellë fshehtësinë tënde, që ajo për njerëzit të jetë dritë dhe shpresë. Për këto të lutemi nëpër Krishti, Zotin tonë.

Të gjithë : Amen.

**LUTJA E ZOJES SË BEKUAR shiko më lartë**



## **NXITJA PËR ZBATIM PERSONAL**

O Zot, kam nevojë të madhe për dhuratën e KËSHILLËS. Ndonjëherë është gati e pamundur, sepse çdo ditë, çdo orë kërkohet të marr vendime, por unë shpesh nuk e di ç' të bëj. Këtu vijnë edhe të tjerët me problemet e veta, por unë jam i pa fuqishëm. Kënd Ti e shndrit me Shpirtin tënd, ai është i aftë për vendime të drejta. Ndihet i sigurt në pritjet që ke ndaj tij: nuk shkon pas dëshirave dhe fantazive të veta. O Zot, Ti nuk i do ata që kanë kokë të fortë, dhe mendjen e madhe; me ndihmo që të jam i zgjuar dhe të shkoj pas nxitjes tënde. Me jep po të lutem SHPIRTIN E KËSHILLES!

## **LUTJE E SHKURTËR**

Udh. : O Zot, jepu mësimin e vërtet të gjithëve, që ta kërkojnë kuptimin dhe qëllimin e jetës, po të lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

Udh. : Ndihamo prindërit e të gjithë atyre që edukojnë rininë, po të lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

Udh. : Që të jesh me refugjatët, sepse Ti ke thënë Shpirti Shenjt do të flas për ata, po të lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

## **MESHTARI**

O Zot, Ati i gjithëpushtetshëm – Ti dëshiron që të shëlbohen të gjithë njerëzit dhe të arrijnë ta kuptojnë të vërtetën. Po të lutemi bëj që Kisha jote të jetë themeli dhe shtylla e të vërtetës, që mbarë veprimtaria e saj të jetë në lavdinë tënde dhe për shëlbimin e njerëzve. Këto t'i lusim nëpër Krishtin Zotin tonë.

Populli: Amen!

## **LUTJA E ZOJËS SE BEKUAR shiko më lartë**



## **NXITJA PËR ZBATIMI PERSONAL**

Ndonjëherë thjeshtë më kap frika. Kjo vjen kur mendoj se si do të reagojnë të tjerët ndaj meje. Nuk është lehtë të jesh i krishterë, shumë shanse do të na kalojnë në qoftë se i jemi besnik kësaj zgjedhje jetësore. O Zot, unë e di që Ti i ke mjetet e shëlbimit kundrejt dëshpërimeve të mia. Ti ke mundësi të më dhurosh fuqinë për të cilën kam nevojë për çdo ditë: në thirrjen time... në famullinë time... në familjen time... në jetën time personale. Pa Ty nuk kam duresë, as me veten, as me të tjerët. Pa Ty nuk jam i aftë të bëjë as një sakrificë të cilën e kërkon prej meje; kur më thërret që të ndihmoj për të mbajtur kryqin e vëllaut ose motrës. O Zot, i përvujtërisë të lutem; më jep DHURATËN E FORCËS!

## **LUTJA E SHKURTËR E BESIMTARËVE**

Udh. : O Zot, jepu fuqi të gjithëve që janë të lëkundshëm / dhe në pasiguri që të vendosin qartë për jetën e krishterë, po të lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

Udh. : Që të jesh me Shenjtin Atë Papë, me Ipeshkvihtë, / meshtarë dhe rregulltarë që t'i forcosh në momente të rënda, po të Lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

Udh. : Që të jesh drita e të verbërve, fuqia e të dobëtëve, / shpresa e të vobektëve, po të lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

## **MESHTARI**

O Zot, i madh dhe i fortë – vetëm nëpër Ty gjejmë mbështetje dhe siguri. Vepro nëpër shpirtin tënd në Kishë edhe pse është e ndërtuar në dobësitë njerëzore, mbetët e palëkundshëm në fe dhe e durueshme në persekutime. Këto t'i lusim nëpër Krishtin Zotin tonë.

Të gjithë: Amen.

**LUTJA E ZOJES SE BEKUAR shiko më lartë**



## **NXITJA PËR ZBATIMI PER ZBATIM PERSONAL**

Kur rrëmoj vetën bëhem i vetëdijshëm se kam shkuar larg me gjykimet e mia. Shpesh dëshiroj të mbështetem në mendimet e mia, dhe jo në të vërtetat e fesë. O Zot, me jep dhuratën e Dijes që të jem i sigurt në atë që Ti ke zbuluar... Çka kanë predikuar apostujt... ç' është feja e Kishës. Me ndihmo që me anën e dhuratës se dijes të qëndroj shpirtërisht i hapur, që të kuptoj sa më mirë fshehtësinë e fesë dhe të mos mbyllem për para zbulimeve të reja. Porosia jote është e madhe dhe ne kur nuk mund ta konceptojmë e ta kuptojmë. Ajo fsheh në vetvete shumë çka; momente gëzimi dhe mundësi për ta shndritur me dritë jetën time dhe jetën e të afërmeve të mi, nëse arrijmë të kuptojmë ato me mirë. O Zot, më jep mua, jepna neve, jo vetëm teologëve dhuratën e Shpirtit Shenjt, dhuratën e DIJES:

### **LUTJA E SHKURTËR E BESIMIT**

Udh. : O Zot, nëpër Fjalën e Kishës tënde udhëheq besimtarët në të vërtetën tënd, të lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

Udh. : Jepu teologëve të Kishës frikën e Tenzot para zbulimeve të fshehtësisë tënde, të lutemi:

P. : O Zot, dëgjona ne!

Meshtari:

O Zot, në Shpirtit Shenjt ti bënë që ne të jemi pjesëmarrës të jetës tënde Hyjnore. Na mbush me përvujtëri e admirim. Na ndihmo që të mos harrojmë kurrë që të kuptuarit tonë është i kufizuar, por ne jemi sipas masës së dashurisë që na ke dhuruar neve nëpër Jezu Krishtit Zoti tonë.

P. : Amen.

**LUTAJ E ZOJES SE BEKUAR shiko më lartë**



## **NXITJA PËR ZBATIM PERSONAL**

O Zot, Ti na le që të thërrasim Ati ynë, dhe ke dëshirë që të gjithë të jemi bijtë e tu. Kjo nuk është e lehtë dhe kërkon më shumë se fjalët e bukura; kjo kërkon dhurimin, sipas shembullit të Jezu Krishtit Birit tënd, Zoti tonë. Prej atij i cili ka dhuruar vetveten krejtësisht nuk mund të shpërblehemi me një dhuratë të vogël. Dhurimi e vetës tonë tek Ti na sjell mbrojtje prej teje – nëse me të vërtetë e kemi dhuruar vetën tek Ti. Por, mbrojtja kërkon që të them po, edhe atëherë kur mundem ta parashikojmë në mënyrë njerëzore. Mbrojta jote dhuron lirinë e brendshme në të cilën njeriu nuk mund ta prekë as një fuqi, as një pushteti... as pushteti i modës se re... mashtrimit ... grabitjes. Ky njeri i lirë, është njeri i devotshëm. Ai qëndron në praninë tënde dhe me këtë në nivelin e kohës së vet: Ai ka mundësinë t'i sjellë botës së vetë një pjesë të shëlbimit. Bota pa shëlbim ka nevojë për njerëz të devotshëm. O Zot, me jep për shkak të obligimeve të mia ndaj botës SHPIRTI PËRSHPIRTËRISË.

## **LUTJA E SHKURTËR E BESIMTAREVE**

- Udh. : O Zot, mësoi njerëzit ta kuptojnë / se dinjiteti i tyre është në adhurimin përpara Madhërisë tënde, të lutemi:  
P. : O Zot, dëgjona ne!  
Udh. : Ruaje tek besimtarët Shpirtin e dëgjesës / që të veprojnë sipas nxitjes së Shpirtit Tënd të Shenjt, të lutemi:  
P. : O Zot, dëgjona ne!  
Udh. : Ushqej të uriturit, / të pasurve jepu etje për bekimet e tua, të lutemi:  
P. : O Zot, dëgjona ne!

## **MESHTARI:**

O Zot, Hu ynë – Ti dëshiron që Ty të adhurojmë në shpirt dhe në të vërtetën. Na ruaj nga devocione të gabuara të cilat kërkojnë vetën në lutjen dhe në punë. Na hap sytë që në jetë të njohim dashurinë tënde dhe ta lëvdojmë atë. Këto i lusim nëpër Jezu Krishtin Zotin tonë...  
P. : Amen.

## **LUTJA E ZOJES SE BEKUAR shiko më lartë**



